



07/03/2017 12:22

Me i fundit



Tensionet me SHBA e Tajvanin, Kina zgjeron flotën detare

Borxhi shkaktar i vrasjes në Pejë, i dyshuari është kushëri i Xhavit Halitit

Gazeta Express ka kontaktuar me avokatin e të dyshuarit, Bahtir Troshupa. Ai ka deklaruar për Express se mbrëmë i ka sugjeruar klientit të tij që të mbrohet në heshtje pasi që gjendja e tij shëndetësore nuk ka qenë e mirë.

"Klientin tim për shkaqe shëndetësore mbrëmë nuk e kam lejuar që të japi deklaratë. Ka qenë i stresuar. Shkaku ka qenë i një borxhi, klienti im i ka pasur një borxh viktimës. Ekspertiza mjeko-ligjore do ta vërtetojë të gjitha", ka thënë Troshupa për Gazetën Express.

Lexo Edhe:

Tensionet me SHBA e Tajvanin, Kina zgjeron flotën detare

Ai ka thënë se Kreshnik Haliti, është kushëri i largët i deputetit të PDK'së Xhavit Halitit. Ndërkohë që Policia e Kosovës sot gjatë ditës me anë të një komunikate ka bërë të ditur se kanë arritur që ta arrestojnë të dyshuarin Kreshnik Haliti ku edhe i ka konfiskuar armën e tipit "PJETRO BERETA" cal: 7.65mm dhe 1 karikator i zbrazët i armës përkatëse me të cilën dyshohet se kryesi e ka përdorur gjatë kryerjes se veprës penale".

Avokati mbrojtës Bahtir Troshupa po i konteston deklaratat e policisë se ai është arrestuar. Sipas Troshupës, klienti i tij mbrëmë është vetëdorëzuar në policinë e Pejës, dhe se arma nuk ka qenë e tij por e viktimës.

"Klienti im është vetëdorëzuar në polici. Arma nuk ka qenë e klientit tim, por e viktimës", ka thënë tutje avokati mbrojtës i të dyshuarit për vrasjen në Pejë, Kreshnik Halitit. Ndërkohë që prokurori i rastit, Haxhi Sinanaj ka bërë të ditur për Express se të dyshuarit i është caktuar masa e ndalimit prej 48 orëve.




Share Now




Tjera nga rubrika



Tensionet me SHBA e Tajvanin, Kina zgjeron flotën detare



Sejdiu: Kemi pasë raste të shumta për shkelje kushtetuese, nuk kanë dhënë dorëheqje



Korab Sejdiu: Politika ka degraduar, kjo është legjislatura më e dobët



Momenti kur Melihate Tërmkolli i thotë Tomë Gashit "çuti" dhe ky ia kthen "zoti Tërmkolli"



Zbulohet testi i alkoolit që detekton Covid-19 përmes frymëmarrjes, jep rezultate brenda një minuti



Artistja e njohur shqiptare shfaqet përkrah Richard Grenell, mbështet Trumpin në zgjedhje

Te fundit



Tensionet me SHBA e Tajvanin, Kina zgjeron flotën detare



Sejdiu: Kemi pasë raste të shumta për shkelje kushtetuese, nuk kanë dhënë dorëheqje



Korab Sejdiu: Politika ka degraduar, kjo është legjislatura më e dobët



Momenti kur Melihate Tërmkolli i thotë Tomë Gashit "çuti" dhe ky ia kthen "zoti Tërmkolli"



Zbulohet testi i alkoolit që detekton Covid-19 përmes frymëmarrjes, jep rezultate brenda një minuti



Artistja e njohur shqiptare shfaqet përkrah Richard Grenell, mbështet Trumpin në zgjedhje